

URDHËR
Nr. 488, datë 4.6.2026

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS PËR NËNSHKRIMIN E
CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË UDHËRRËFYESIT
TURISTIK**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore” dhe të pikës 2/1, të vendimit nr. 692, datë 5.10.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores, ‘Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre’, i ndryshuar”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës për nënshkrimin e certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, të individëve të certifikuar nga Komisioni i Standardizimit të Veprimtarive Turistike, të z. Xheni Beqaj, drejtor i përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Bregdetit.

2. Ngarkohet z. Xheni Beqaj, drejtor i përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
Blendi Gonxhja